



**Data: 15/08/2024**

**PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS - MALL  
PROCEDURË E HAPUR MBI KUFIRIN E LARTË MONETAR  
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE  
PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROCEDURËS:** “Furnizim vendosje i kushinetave rrëshqitëse në aksin e rrotullimit të farfallës së droselit për 4 AG në HEC Koman dhe një set rezervë”.

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):** PAJISJE TË NDRYSHME -39300000-5.

**VLERA E FONDIT LIMIT:** 95,000,000 (Nëntëdhjetë e pesëmilion) Lek, pa TVSH ose 951,999 (Nëntëqind e pesëdhjetë e njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë) Euro pa TVSH.

***Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 15/08/2024 është 99.79 Lekë/Euro***

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sh.a, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

- a. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*
- b. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

### **Argumentimi:**

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82, “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Nenit 83 “Sigurimi i ofertës” të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar.

Në Nenin 83 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” citohet: “Autoriteti Kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Në Nenin 82, të LPP, i ndryshuar, “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet Kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):** me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

### **Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, i ndryshuar, nenin 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës së fondit limit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP, i ndryshuar, si dhe nenin 43, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në dispozitat e legjislacionit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. VKM-së nr.922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”.

Duke marrë në konsideratë specifikën e mallrave objekt procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për tre vitet e fundit financiare të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës së përlogaritur e fondit limit.

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 39% e fondit limit.

*Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:*

- a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 40, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Duke marrë në konsideratë kontratën objekt prokurimi është menduar se vlera e kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë realizuar me kontratat e ngjashme të jetë brenda vlerës kufi të përcaktuar në këtë mënyrë Autoriteti Kontraktor ka sigurinë dhe besueshmërinë që operatori ekonomik ofertues do realizojë me sukse kontratën objekt prokurimi.

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim nga Prodhuesi ose Distributori i Autorizuar për pajisjet dhe shërbimet që do të ofrojë.

*Dokumentacioni duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, ëbsite kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit.*

**Argumentimi:** Kriteri i mësipërm është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Kërkesa për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit se operatorët ekonomikë janë të autorizuar nga prodhuesi apo distributori i autorizuar është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave dhe shërbimeve. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave dhe shërbimeve që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standardet. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës.

**2.3.3** Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogun e prodhuesit/ve, të përkthyer në gjuhën shqipe në pjesët ku përcaktohen specifikimet teknike të mallrave objekt prokurimi, me të dhënat dhe karakteristikat teknike, në mënyrë që të provohet pajtueshmëria me specifikimet teknike. Katalogët duhet të jenë të verifikueshëm në ëbsite të tyre përkatës.

**Argumentimi:** Kërkesa për paraqitjen e katalogut/ëve është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 6, gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar, si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi.

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij:

- Minimumi 2 (dy) Inxhinier Mekanik.

**Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaramit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaramit si:**

- Kontratë pune të vlefshme;
- Diploma;
- Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për të paktën Maj 2024 – Korrik 2024.

**Argumentimi:** Kërkesat për punonjësit, janë kërkuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, gjithashtu inxhinieri mekanik është i nevojshëm gjatë procesit të zbatimit pasi nyja e droselit është një element shumë i rëndësishëm për funksionimin e agregatëve në aspektin e sigurisë së tyre. Procesi i zëvendësimit të kushinetave rrëshqitëse të farfallës së droselit është një process kompleks i cili kërkon të respektohen kushtet teknike të tyre. Në momentin

kur të realizohet demontimi i kushinetave ekzistuese do të realizohet një inspektim dhe vlerësim i detajuar në lidhje me vlerësimin e ashpërsisë së sipërfaqes, matja e dimensioneve dhe llogaritja e tolerancave të montimit. Gjithashtu përpara montimit të kushinetave të reja do të realizohet procesi i pozicionimit të farfallës së droselit duke respektuar tolerancat në të dy suportet ku do të mbështeten kushinetat rrëshqitëse. Të gjitha këto procese kërkojnë njohuri teknike të thelluara në fushën e inxhinierisë mekanike dhe gjithashtu duke marrë në konsideratë dimensioned e mëdha të nyjes së droselit është e domsdoshme të jenë të pakten 2 ing mekanik në këtë proces.

### **2.3.5** Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij:

- Minimumi 1 (një) Specialist, i cili të jetë ekspert i çertifikuar për kontrollet NDT, sipas standartit SSH UNI EN ISO 9712 ose ekuivalent.

**Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaramit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaramit si:**

- Kontratë pune të vlefshme;
- Çertifikatat e mësipërme të vlefshme;
- Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për të paktën Maj 2024 – Korrik 2024.

**Argumentimi:** Kërkesat për punonjësit, janë kërkuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, gjithashtu Specialist, i cili të jetë ekspert i çertifikuar për kontrollet NDT, është i nevojshëm gjatë procesit të zbatimit pasi pas demontimit të kushinetave ekzistuese të aksit të farfallës së droselit një process shumë i rëndësishëm do të jetë dhe inspektimi i suportit të kushinetës dhe i aksit të farfallës për të vlerësuar nëse ka dëmtime strukturore. Mënyrat e inspektimit të këtyre detaleve në të tilla procese realizohen duke aplikuar metodat e kontrollit pa shkatërrim NDT ( kontrolli me penetrant, kontrolli me ultratinguj ose kontrolli magnetik). Për këtë arsye është e nevojshme që të jetë minimalisht një specialist i fushës i certifikuar sipas standartit përkates.

### **2.3.6** Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij:

- Minimumi 2 (dy) specialist skelash
- Minimumi 2 (dy) specialist të punimeve në lartësi
- Minimumi 3 (tre) mekanikë

**Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaramit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaramit si:**

- Kontratë pune të vlefshme;
- Dëshmi kualifikimi;
- Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për të paktën Maj 2024 – Korrik 2024.

**Argumentimi:** Kërkesat për punonjësit, janë kërkuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, gjithashtu specialistët e kërkuar në këtë kriter janë të nevojshëm në zbatimin e kësaj kontrata për proceset si më poshtë:

**-Specialist skelash,** Duke qenë se nyja e droselit është e madhe rezulton që lartësia e pozicionit të demontimit/montimit të kushinetave nga dyshemeja e sallës së droselave është afërsisht rreth 6m, për procesin e demontimit dhe montimit të kushinetave rrëshqitëse është e nevojshme që të ndërtohen skela me qëllim aksesimin nga punonjësit. Skelat do të ndërtohen nga të dy anët e droselit njëkohësisht që të dy pozicionet e kushinetave rrëshqitëse.

**-Specialist të punimeve në lartësi,** Duke qenë se nyja e droselit është e madhe rezulton që lartësia e pozicionit të demontimit/montimit të kushinetave nga dyshemeja e sallës së droselave është afërsisht rreth 6m dhe proceset e demontimi/montimit të sistemit të komandimit të farfallës dhe kushinetave rrëshqitëse të droselit janë procese që do të realizohen në lartësi nëpërmjet ndërtimit të skelave. Për këtë arsye është e nevojshme që OE të ketë minimalisht 2 (Dy) specialist të certifikuar për punimet në lartësi.

**-Mekanikë,** Demontimi/montimi i elementëve të komandimit të farfallës dhe kushinetave rrëshqitëse të droselit janë procese mekanike të cilat ndër të tjera konsistojnë në cmontimin dhe montimin e lidhjeve me buloneri, shkëputjen e sistemit hidraulik të komandimit të farfallës, heqjen e kundrapeshave, etj. Për këtë arsye është e nevojshme të jenë të pranishëm 3 mekanike për të realizuar këto procese.

**2.3.7** Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Çertifikatat **ose ekuivalentet e tyre**, në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

- ISO 9001 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”;
- ISO 14001 “Sistemi i menaxhimit të mjedisit”;
- ISO 45001 “Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”;

**Argumentimi:** Kërkesa në lidhje me këto çertifikata është në përputhje me nenin 44 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe nenin 79 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

**ISO 9001 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”** - Ky standard është i nevojshëm për çertifikimin në realizimin e cilësisë, identifikimin e rrisqeve, caktimin e burimeve të nevojshme për të kontrolluar nëse mallrat e ofruar janë të cilësisë së duhur si dhe kontrollin e proceseve.

**ISO 14001- “Sistemi i menaxhimit të mjedisit”** - është e nevojshme që Kontraktori të ketë staf të vetëdijshëm për politikën mjedisore dhe pasojat e mundshme të aktiviteteve të tyre në mjedis. Aktivitetet e Kontraktorit duhet të jenë të tilla që të kontrollohet ndikimi në mjedis dhe të përgjigjet në rast emergjence të ndikimit në mjedis.

**ISO 45001 “Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”** - Ky standart është i nevojshëm për ndërgjegjësimin e gjithë personelit të shoqërisë në lidhje me masat e mbrojtjes së shëndetit, sigurisë dhe konsultimit të punësuarve për vlerësimin e rrisqeve të shëndetit dhe sigurisë në punë.

**2.3.8** OE duhet të paraqesë një propozim teknik nga prodhuesi /distributori i autorizuar, bazuar në specifikimeve teknike.

**Argumentimi:** Kërkesa në lidhje me propozim teknik nga prodhuesi është kërkuar pasi:

Propozimi teknik i prodhuesit ka shumë rëndësi që AK të verifikojë, që setet e kushinetave përputhen me dimensionet, cilësia e përbërjes së materialit lubrifikues, metodika e lubrifikimit janë sipas specifikimeve teknike etj.

Në këtë mënyrë krijohet bindja tek Autoriteti Kontraktor që produkti që do të furnizohet do të plotësojë të gjitha kërkesat sipas specifikimeve teknike dhe që prodhuesi ka kapacitetet teknike për të projektuar dhe prodhuar produktet objekt prokurimi.

**2.3.9** Operatori Ekonomik ofertues për realizimin e kontrates, duhet të disponojë këto pajisje dhe makineri:

<b>Emri i Mjetit</b>	<b>Njësi</b>	<b>Sasi</b>	<b>Statusi</b>
Pajisje për shpimin në metale	cope	3	Ne pronesi ose me qera
Skeleri dhe platforma metalike të ndryshme	M <sup>2</sup>	100	Ne pronesi ose me qera
Pajisje hidraulike për prerje metalesh	cope	2	Ne pronesi ose me qera

**Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaratimit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaratimit si:**

Si dëshmi për të vërtetuar disponimin e pajisjeve teknike në pronësi/qira do të paraqiten këto dokumente:

- a) Për pajisjet operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij si psh, aktet e zhdoganimit ose faturë tatimore të shitblerjes orgjinale ose fotokopje të notuar ose kontratë qiraje të noterizuar.

**Argumentimi:** Kërkesat për punonjësit, janë kërkuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,

-Paisjet për shpime në metale janë të domosdoshme për demontimin e kushinetave ekzistuese.

-Skelerite janë të nevojshme pasi do të rrethohet komplet droseli në mënyrë që të arrihet të punohet te kushinetat.

-Paisje hidraulike për prerje metalesh është e nevojshme për demontimin, pasi kemi të bëjmë me një mekanike që kanë 10 vite në operim.

***Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.***

**Shënim:** Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

**Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njësimin e dokumenteve.**

### **I. Argumentimi i specifikimeve teknike:**

*Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, sipas parashikimeve të nenit 36 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.*

Termat e referencës për “Furnizim vendosje i kushinetave rrëshqitëse në aksin e rrotullimit të farfallës së droselit për 4 AG në HEC Koman, dhe një set rezervë”, janë hartuar referuar projektit të rehabilitimit të kësaj nyje. Që do të thotë që dimensionet edhe përmasat ekzistuese janë kusht i padiskutueshëm. Metodika e demontimit dhe montimit është e përcaktuar pa demontimin e komplet droselit pasi zëvendësimi duhet të realizohet shumë shpejt.

Afatet e realizimit të kontratës janë përcaktuar duke marrë parasysh kohën që kërkojnë fabrikat për prodhimin e nyjeve, dhe për AG2 koha e demontimit dhe montimit është shumë emergjente.

### **Njësia e Prokurimit**